

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Punësimi i pensionistëve dyfishohet në tre vjet! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/punesimi-i-pensionisteve-dyfishohet-ne-tre-vjet/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 06:43:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 06:32:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c886b152791e7a7299d7eaf5c37b47da7518365dfb95c878b04dc195bf410f09
TEKSTI	fa4e9ae5ec5f85445dbcb14b057abd208a639f1570c99471fb5609d7a08a2967
PAMJA	cb4390d16be9604969e4d3cfbdf881bcc2f113ff8b961742ea936541141255d0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a0b6b627bd679ca9f0c2a99ae4edc971bba9921b2cf03d9141b9bb5a6ef612e7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7552192d4562aa207666eadcaed525346db194fc39c694c2be0ac3ebbafe5dc8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a0b6b627bd679ca9f0c2a99ae4edc971bba9921b2cf03d9141b9bb5a6ef612e7

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Aktualitet Sociale

Punësimi i pensionistëve dyfishohet në tre vjet!



Dorjana Lato

17 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Numri i personave mbi 64 vjeç që vijojnë të jenë të punësuar po rritet me ritme të shpejta, në një kohë kur të rinjtë po përballem me rritje të papunësisë dhe rënie të punësimit.



Të dhënat zyrtare të INSTAT-it tregojnë se në tremujorin e dytë të vitit 2026, numri i të punësuarve mbi 64 vjeç arriti në rreth 145 mijë persona. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur ishin 131.2 mijë të punësuar, numri është rritur me rreth 13.7 mijë persona, ose 10.5%.

Rritja ishte edhe më e fortë në tremujorin e parë të vitit. Në janar-mars 2026, në tregun e punës kishte 140.7 mijë të punësuar mbi 64 vjeç, me rritje prej 14.4% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Zgjerimi i punësimit në moshat më të mëdha po ndodh në një treg pune ku kompanitë po e kanë gjithnjë e më të vështirë të zëvendësojnë punonjësit që dalin në pension.

Emigracioni dhe tkurrja e brezave të rinj që hyjnë në tregun e punës kanë kufizuar ofertën për punonjës, ndërsa jo gjithmonë aftësitë dhe profilet e të rinjve përputhen me vendet e lira që kërkojnë të plotësojnë bizneset.

Në disa sektorë, mungesa e përvojës profesionale, kërkesa për aftësi specifike dhe interesi më i ulët i të rinjve për disa profesione apo zanate e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e punonjësve të vjetër.

Shumë biznese mendojnë se mbajtja në punë e një punonjësi me eksperiencë mund të jetë më e

lehtë sesa gjetja dhe trajnimi i një punonjësi të ri.

“Të dhënat tregojnë se rritja e punësimit mbi moshën 64 vjeç është bërë më e qëndrueshme që nga fundi i vitit 2024.

Në një krahasim më afatgjatë, ndryshimi është edhe më i fortë. Në tremujorin e dytë 2023, numëroheshin vetëm 71 mijë të punësuar mbi 64 vjeç, ndërsa tre vjet më vonë, numri mëse u dyfishua.

Përveç kërkesës së bizneseve për punonjës me përvojë, vazhdimi i punës pas moshës 64 vjeç mund të lidhet edhe me nevojën për të siguruar të ardhura shtesë.

Për një pjesë të personave që kanë arritur ose po i afrohen moshës së pensionit, qëndrimi në tregun e punës mbetet një mënyrë për të plotësuar të ardhurat familjare. Teksa pagat dhe kostot e jetesës po rriten, pensionet e reja të pleqërisë nga viti në vit po vijnë në ulje.

“Ata që dolën në pension vitin e kaluar përfituan mesatarisht 14,496 lekë në muaj ose 3% më pak se ata që dolën në pension më 2024-ën. Kështu që për shumë të moshuar, aktivizimi në tregun e punës mbetet e vetmja mundësi për mbijetese.

Të dhënat zyrtare të Eurostat-it tregojnë se sistemi i pensioneve në Shqipëri regjistron shkallën më të ulët të zëvendësimit në të gjithë hapësirën europiane. Pensioni mesatar bruto në vend përfaqëson vetëm 30% të pagës mesatare të grupit moshor aktiv 50-59 vjeç.

Ky nivel e pozicionon Shqipërinë jo vetëm në fund të Ballkanit Perëndimor, por edhe në skajin më të ulët krahasuar me të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian, ku mesatarja e bllokut është e qëndrueshme, në rreth 57-605 të pagës mesatare.

Në një tjetër raport të Anketës Europiane të Kushteve të Punës (EWCS 2024), Shqipëria ka nivelin e pensionit ndër më të ulët në Europë, burrat shqiptarë janë ata që duan të lënë punën më vonë se çdo popull tjetër në Europë.

Mesatarisht, ata deklarojnë se do të dëshironin të punonin deri në moshën 67.4 vjeç, niveli më i lartë mes 35 vendeve të analizuara, që përfshijnë vendet e Bashkimit Evropian, Ballkanin Perëndimor, vendet e EFTA-s dhe disa shtete të tjera evropiane./Monitor

LAJME TË NGJASHME



Papunësia e të rinjve rritet 16%!

2 MIN



Kanadaja propozon ndalimin e rrjeteve sociale për të miturit nën 16 vjeç!

1.5 MIN



“Arena Kombëtare” transformohet për Europeanin e të rinjve, nis puna për ndërrimin e tapetit të fushës

1 MIN



Sot Dita Botërore Pa Duhan/Nikotina vazhdon të fitojë terren!

2.5 MIN



Shenjat që shumë i injorojnë... Ekspertët paralajmërojnë për simptomat e hershme të demencës tek të rinjtë!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."



Trupi gjyqës: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Haga/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim



Haga rrëzon një nga pretendimet e Prokurorisë: Nuk kishte krime kundër njerëzimit nga udhëheqësit e UÇK-së



Ish-krerët e UÇK-së lihen në burg, reagon Rama: Marre




Mbyllet seanca në Hagë, Konjufca: Vendim i padrejtë dhe i pamerituar

EDITORI SUGJERON



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë..." / Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam menduar të bëj in vitro!



"Të kisha çerekun e egove të kolegeve të mia..." / Çiljeta Xhilaga: Nuk kam vuajtur për vëmendje!




10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të vëçit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!





Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...



Lorenc Hasrama risjell këngën e Flori Mumajesit live në studio!



Lorenc Hasrama kujton situatën më qesharake që i ka ndodhur në koncert!



Cili ka qenë përfaqësimi më i mirë në "Eurovision" sipas Lorenc Hasramës...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

[Kontaktoni Marketing](#)
[Frekuencat](#)
[Aksesueshmëria](#)
[Mundësi Punësimi](#)
[Privacy Policy & Terms](#)

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.